




REPublika e Kosovës AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		REPUBLIC OF KOSOVO AGENCY AGAINST CORRUPTION	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	2-D/DPK	Prot. No.	01-3838/12
Nr. i tau		Data	
Broj stranica	02	Datum	24.10.2012
Nr. pages			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.10.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-5104/11, për z. Arben Bilalli, Drejtor i Administratës dhe i Financave ne Komisionin e Pavarur për Media, pasi qe zyrtari i lartë ka shmangur gjendjen e Konfliktit te mundshëm te Interesit ne te cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marre gjate kontrollit te formularit për deklarim te pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-5104/1, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë z. Arben Bilalli, Drejtor i Administratës dhe i Financave ne Komisionin e Pavarur për Media (KPM) .

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Drejtor i Administratës dhe i Financave në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si person i autorizuar dhe pronar ne biznesin “AR&BI –SH.P.K” e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 17.04.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të

Interesit dhe se ka të drejte që në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z. Arben Bilalli, ka ardhur në Agjenci dhe ka kërkuar të njoftohet me gjerësisht për situatën. Gjatë takimit është njoftuar në detale se për cilën situatë kanë filluar hetimet për Konflikt të Interesit.

Zyrtari i lartë z. Arben Bilalli, është pajtuar për gjendjen, mirëpo është arsyetuar se biznesi në fjalë është i regjistruar po nuk ushtron veprimtari dhe është zotuar se në afatin më të shkurt do të bëjë kërkesën për mbylljen e këtij Biznesi për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas këtij takimi, Zyrtari i lartë z. Arben Bilalli, ka sjellë në Agjenci kërkesën që ka bërë pranë ATK-së, për ta bërë shuarjen e këtij biznesi, si dhe dëshminë e publikimit në gazetën ditore për likuidim të Biznesit sipas procedurave.

z. Bilalli, ka qenë në kontakt me zyrtarët e agjencisë deri në momentin kur e ka sjellë dëshminë nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK-se), ku dëshmohet se z. Bilalli, nuk është me person i autorizuar në biznesin "AR&BI –SH.P.K", dhe procesi për shuarje të biznesit vazhdon për shkak të procedurave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë z. Arben Bilalli, Drejtor i Administratës dhe i Financave në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), është larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin "AR&BI –SH.P.K", dhe nuk mban me pozitë udhëheqëse dhe e ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej. Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Drejtor i Administratës dhe i Financave në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), dhe pozitës si person i autorizuar në biznesin "AR&BI –SH.P.K".

Pas ndryshimeve që janë bërë dhe gjendjes faktike tash, z. Arben Bilalli nuk gjende t në situatën e konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

